REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 170, Datë 15.06.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ALBESP TRADING & CONSULTING" SH.P.K. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma "d" të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma "e", 5, pika 1, gërma "e", 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma "a" të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.06.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1565/2 prot., datë 10.06.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike"*,

Konstatoi se:

- Shoqëria "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 02.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 02.12.2026.
- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1565/1 prot., datë 26.05.2026.
- Në nenin 16, pika 1, të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"* të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 493, Seria T21, është 02.12.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 02.06.2026.
- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të Rregullores.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"* të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të Rregullores, vlerësohet se shoqëria duhet të sqarojë/depozitojë dhe sa vijon:

- *informacion mbi stafin teknik aktualisht efektiv;*
- *vërtetimin që shoqëria nuk ka detyrime të papaguara ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;*
- *dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë dhe për administratorin e saj;*
- *mbështetjen financiare për vlerën e mbetur për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike dhe vendimin e organeve drejtuese për dedikimin përkatës të shumës për secilën veprimtari sipas përllogaritjeve.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 493, Seria T21, të shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 02.12.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI